

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit
ADRESA	https://piranjat.al/politike/birn-zyrtaret-e-larte-dhe-i-i-organizuar-u-bene-njesh-ne-mbrojtje-t-i105958
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 06:32:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 06:29:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9473d9be60d1fe4c347492a6837d344bdd11dc2595cb1e1a34782f408f0e4cdb
TEKSTI	bdd9121dce178a397e28dd1a310570b22942acb25f6fdf9366e05713469df5ed
PAMJA	4cc81f0ee9c6067beb6d97af48ae0c1a29af69e2a01048a22530d22407edef0a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6f675e07af61797cd5a0e9341510f73b32db1e38b25bbd8ce433b7c170c8a1f0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	491fbc2f0e2919ed311b022f1b5f92632a55c8ad6fb3d3a6ed9398e35c5643c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6f675e07af61797cd5a0e9341510f73b32db1e38b25bbd8ce433b7c170c8a1f0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

**mbrojtje
të Ergys**

një kompleks
vilash të

**ministri i
Brendshëm:
Përcaktuesit**

përshirë
ish
drejtuesen e

SOT

jugor ku
mëng...

**nuk po
paguajnë;
Të ardhurat**

më të
dobët në
buxhetin

**dyert e
suksesit**

enkont se
cilat janë
përparësit...

FR

POLITIKE

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 08:29



Mëngjesin e 22 shtatorit, forcat e Policisë së Shtetit zbarkuan për kontroll në një kompleks vilash të fortifikuara në periferi të Durrësit – një strehë e dyshuar e Ergys Agasit gjatë muajve të tij të arratisë.

Sipas njoftimit të SPAK, kontrolli u krye në zbatim të një vendimi të Gjykatës së Posaçme si pjesë e një hetimi më të gjerë të ndërmarrë ndaj një rrethi zyrtarësh të lartë, që dyshohet se ishin në kontakt apo e ndihmuar Agasin gjatë arratisë.

Subjekte të vendimit gjyqësor për masa sigurie apo kontrollesh ishin shefja e Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni, ish-kreu i Policisë së Shtetit, Ilir Proda dhe zyrtari i Institutit të Policisë Shkencore, Fatjon Kalluci.

Kompleksi ndodhet në një kryqëzim të rrugës “Durrësi në Shekuj” në zonën e Shkollës dhe përbëhet nga disa godina me mure të larta betoni, dritare të izoluara dhe bimë kacavjerrëse që ngjiten deri në katin e sipërm.

Dy burime në dijeni të hetimit i thanë BIRN në kushtet e anonimitetit se kompleksi i vilave ku fshihej Agasi, i pajisur me një nivel të lartë sigurie, zotërohet nga klani “Tropolini”, pavarësisht se në emër të kujt janë regjistruar këto pasuri.

Grupi “Tropolini” konsiderohet nga Prokuroria e Posaçme si një ndër grupet më të rrezikshme të kimit të organizuar në vend, me shtrirje gjithashtu në Itali, Gjermani, Holandë dhe në vendet e Amerikës Latine.

Më 21 maj 2025, SPAK njoftoi goditjen e një organizate ndërkombëtare të trafikut të drogës me qendër në Durrës, ku njëri prej drejtuesve ishte Elvis Doçi. Ai i shpëtoi arrestimit dhe u shpall në kërkim.

Doçi njihet me nofkën “Visi i Pojës” për shkak të lidhjeve familjare me Xhevdet Troplinin, një person i hetuar gjithashtu në mesin e viteve 2000 nga drejtësia italiane për implikim në trafikun e drogës. Ndaj Troplinit nuk është ngritur asnjë akuzë nga drejtësia shqiptare.

Ergys Agasi, 39 vjeç, u shpall në kërkim në dhjetor të vitit të kaluar me akuzën e përfshirjes në krim të organizuar në skandalin e Agjencisë Kombëtare të Shqërsisë së Informacionit, AKSHI, por u arrestua tetë muaj më vonë, më 26 gusht, në zonën e quajtur Plepat në Durrës, teksa po kthehej nga Elbasani ku kishte qëndruar për disa orë. Nga hetimet u siguruan prova që tregojnë se gjatë muajve të arratisë, ai ka lëvizur lirisht nga vendi ku ai fshihej si dhe ka vijuar komunikimet me personazhe të krimit të organizuar dhe funksionarë shtetërorë, kryesisht në Durrës, Tiranë dhe Elbasan.

Burimet në dijeni të hetimit i thanë BIRN se ndonëse informacionet për vendndodhjen e tij ishin të shpeshta, një operacion për kapjen e Agasit u vu në lëvizje vetëm pas një vale ndryshimesh mes drejtuesve të policisë, që pasuan largimin e Ilir Prodës nga pozicioni i kreut të Policisë së Shtetit.

Përfshirja e dyshuar e shefes së shërbimit sekret, Vlora Hyseni në mbrojtje të Agasit gjatë kohës që ai strehohej në kompleksin e grupit Troplini e zgjeron skandalin, duke ngritur pikëpyetje të thella mbi mënyrën e funksionimit të institucionit kyç të sigurisë në Shqipëri dhe raportit mes zyrtarëve të lartë publikë dhe eksponentëve të krimit të organizuar.

Sipas të dhënave të rrjedhura në media nga dosja hetimore, nga qershori deri në gusht të këtij viti, mes Hysenit dhe Agasit janë gjetur më shumë se 500 komunikime telefonike në audio, video dhe mesazhe, në të cilat ajo identifikohet drejtpërdrejt me interesat e Agasit kundrejt institucioneve të drejtësisë që po e ndiqnin penalisht.

Hyseni akuzohet gjithashtu jo vetëm për gatishmërinë për ta ndihmuar Agasin, por për vendosjen në dispozicion të tij të cilësisë së saj si zyrtare si dhe të kapaciteteve të institucionit që ajo drejton.

Mesazhet e rrjedhura në media sugjerojnë se në shkelje të rëndë të detyrës, Hyseni e informonte Agasin për takimet me kryeministrin Rama, zyrtarë të lartë të shtetit dhe homologë të huaj. Gjithashtu, në një makinë të Agasit të sekuestruar në korrik janë gjetur nëntë printime në format të madh të diagramave me të dhëna të ngjashme me ato që prodhohen nga Shërbimi Informativ i Shtetit, të cilat janë në proces verifikimi.

Në një dëshmi përpara Prokurorisë, Hyseni ka pretenduar se kishte komunikuar me Agasin pasi ai ishte ofruar si “bashkëpunëtor”, një version i cili hidhet poshtë nga SPAK.

Hetimet e zhvilluara deri më tani nga SPAK ndaj Ergys Agasit sugjerojnë se ai ka pasur ndikim mbi një numër zyrtarësh të lartë të institucioneve kyçe. Ish-zv.kryeministri në arrati, Arben Ahmetaj e ka akuzuar atë publikisht se luante rolin e “një koordinatori” mes botës së nëndheshme të krimit të organizuar dhe qeverisë së kryeministrit Edi Rama./ BIRN

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 24 Shtator23:03

[Nga shkarkimi në Kosovë te kreu i SHISH/ Berisha: Rama dhe Vlora Hyseni, nën urdhrat e Vuçiç! Haxhiu... kumbari](#)

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka reaguar ashpër pas arrestimit të ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni, duke rikthyer n&...

POLITIKE 24 Shtator22:58

[Ish-deputeti: Dumani pinte kafe çdo të hënë me Vlorën, në qershor të 2025 e përzuri nga zyra](#)

Ish-deputeti Myslim Murrizi ka bërë një deklaratë të fortë lidhur me ish-drejtoreshën e SHISH, Vlora Hyseni. Në Top Sto...

POLITIKE 24 Shtator22:51

[Gazeta franceze: Tjetër skandal në qeverinë e Ramës, BE po e vëzhgon](#)

Nga L'Express Nga shërbimi sekret, në arrest shtëpiak. Kreu i shërbimit të inteligjencës së Shqipërisë (SHIS...

POLITIKE 24 Shtator22:35

[Gazetari Arion Sulo: Faktori ndërkombëtar e ka dhënë lejen për shkarkimin dhe hetimin e Vlora Hysenit](#)

Gazetari Arion Sulo ka folur në “Top Story” për hetimin dhe masën e sigurisë “arrest shtëpie” për ish-drej...

POLITIKE 24 Shtator22:07

[“Shpirti mos e përdor këtë atë numrin tjetër sonte”/ Gazetari Koka zbulon komunikimet e Vlora Hysenit me Agasin](#)

Gazetari Bledian Koka ka zbuluar detaje të reja lidhur komunikimet e ish-drejtoreshës së shërbimit informativ shtetëror, Vlora Hyseni m...

POLITIKE 24 Shtator21:45

[Vlora Hyseni s'ka besim te drejtësia shqiptare: Telefonin ekzaminojeni jashtë vendit](#)

Ish-shefja e SHISH Vlora Hyseni, nuk ka besim te drejtësia shqiptare. Një gjë të tillë e njoftoi gazetarja Anila Hoxha në Top Stor...

POLITIKE 24 Shtator21:45

[Beci: Arrestimi i kreut të SHISH trondit sigurinë kombëtare, ‘piramida e informacionit është rrëzuar](#)

Avokati Eugen Beci, i ftuar në emisionin ‘Çim Peka LIVE’ në SYRI TV, ka komentuar hetimin e SPAK ndaj drejtoreshës së SHI...

POLITIKE 24 Shtator21:43

[E bujshme/ Lala: Nga Rama, te ndërkombëtarët, kë spiunonte Hyseni te Agasi, SHISH u përdor për luftë brenda PS](#)

Gazetarja Klodiana Lala ka thënë se janë plot 503 komunikime mes ish-drejtores së SHISH, Vlora Hyseni dhe biznesmenit Ergys Agasi që SP...

POLITIKE 24 Shtator21:16

"Arrestoni Ramen dhe Ballukun"/ Protestuesit marshim ne rruget e kryeqytetit

Vazhdon marshimi i protestuesve në rrugët e Tiranës në protestën e 117 kombëtare kundër qeverisë. Edhe pse u tha fillim...

POLITIKE 24 Shtator20:56

U paraqit me shallin Louis Vuitton në Parlament/ Punonjësja e markës nxjerr "bllof" Anila Denajn: Është fake

Pas shallit që bëri bujë sot, vjen një tjetër zhvillim që ndryshon tërësisht historinë. Një ndjekës i P...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 24 Shtator

EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar te Trauma. Çfarë n...

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator

Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në një&eum...

AKTUALITET 24 Shtator

EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u ...

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.